

LIGJ
Nr. 14/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRFAQËSOHET NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE
UNICREDIT BANK AUSTRIA AG, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT MBARËKOMBËTAR TË
RADIOTERAPISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG, për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.2.2014

Shpallur me dekretin nr. 8509, datë 6.3.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI NR. 232.653

datë 15 mars 2013

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË
EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE SI
HUAMARRËS DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG SI HUADHËNËS NË LIDHJE ME FINANCIMIN
E PROJEKTIT MBARËKOMBËTAR TË RADIOTERAPISË
130315 MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI (ALBANIA - PHILIPS).DOC

Eur 2,000,000

Kjo Marrëveshje kredie eksporti (Marrëveshja), e datës 15 mars 2013 lidhet ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe që përfaqësohet nga Ministria e Financave (këtu e më poshtë e quajtur “Huamarrësi”); dhe

2. Unicredit Bank Austria AG, një bankë e themeluar rregullisht sipas ligjeve të Austrisë, me zyrën e saj të regjistruar në Schottengasse 6-8, 1010 Vienna, Austria dhe e regjistruar në Gjykatën Tregtare Vjenë me nr. FN 150714p (këtu e më poshtë i quajtur “Huadhënës”),

ndërsa:

A. Më 7 dhjetor 2010, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe qeveria e Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunimin financiar, me qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta ndërmjet të dy vendeve.

B. Philips Austria GmbH ka lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë, Republika e Shqipërisë, marrëveshjen e blerjes të datës 20 dhjetor 2012 për dorëzimin e pajisjeve dhe shërbimeve për Projektin Mbarëkombëtar të Radioterapisë për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, Shqipëri me një vlerë të përgjithshme projekti prej 2.000.000 eurosh.

C. UniCredit Bank Austria AG ka rënë dakord në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në të, të japë financimin e nevojshëm për kontratën e blerjes, të përmendur në B më sipër.

D. Financimi i ofruar Huamarrësit jepet sipas dhe në përputhje me dispozitat e rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë në përputhje me ligjin për nxitjen e eksportit 1981 të ndryshuar dhe mbështetet nga fondet publike të ndihmës me një nivel koncesionaliteti (sipas rregulloreve të OECD-së) prej 35,30 %.

E. OeKB (siç përkufizohet më poshtë) ka shprehur disponibilitetin e saj për të dhënë një garanci të OeKB-së (siç përkufizohet më poshtë), duke e siguruar Huadhënësin kundrejt rrezikut sovran që rrjedh nga financimi i kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me termat dhe kushtet e saj.

Bihet dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME

Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, shprehjet e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Datë e Pranimit” është data në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga të dyja palët dhe ratifikohet nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

“Shtojcë” është një shtojcë në këtë Marrëveshje, ku termat e kësaj shtojce do të konsiderohen të jenë përfshirë në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

“Periudhë e Disponibilitetit” është afati i specifikuar në shtojcën 3 gjatë të cilit Huamarrjet mund të tërhiqen kundrejt Shumës së Kredisë.

“Huamarrje” është një shumë e tërhequr nga Huamarrësi kundrejt Shumës së Kredisë.

“Ditë Pune” është një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe veprime dhe depozita në këmbimin e huaj ndërmjet bankave që mund të kryhen në Vjenë dhe në Tiranë.

“Data e Mbylljes” është data e përkufizuar në seksionin 7.

“Shumë e Kredisë” është shuma e specifikuar në shtojcën 3 kundrejt së cilës Huamarrësi mund të tërheqë Huamarrjet gjatë Periudhës së Diponibilitetit.

“Euro” ose “€” monedha e vetme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që miratojnë euron si monedhë të tyre në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Evropian në lidhje me Bashkimin Evropian Ekonomik dhe Monetar.

“EURIBOR” është norma e përqindjes në vit e barabartë me vlerën aktuale mbi bazën e marrëveshjes 365/360 të mesatares së normës së depozitave EURIBOR-it të miratuara me EURIBOR FBE (faqe 248) për një periudhë të barabartë me periudhën për të cilën interesi duhet të caktohet nga Huadhënësi (seksioni 3.3), në ose rreth orës 11:00 në Bruksel në ditën e dytë të punës para fillimit të periudhës përkatëse të interesit. Në këtë kontekst, “FBE” do të thotë “Federation Bancaire Europeenne”.

“Llogari e Huas” është llogaria e hapur në emër të Huamarrësit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.3.

“Datat e Pagesës së Interesit” është 31 marsi, 30 qershori, 30 shtatori dhe 31 dhjetori i çdo viti, me kusht që nëse një datë e tillë nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

“Periudhë Interesi” është një periudhë:

- i) që fillon në datën e Huamarrjes ose në ditën e fundit të periudhës së saj të mëparshme të interesit; dhe
- ii) që mbaron më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor në çdo vit.

“Barrë” është çdo hipotekë, tarifë, peng, barrë, hipotekim, detyrim, ruajtje titulli ose çdo interes tjetër garancie të çdo lloji dhe që ka lindur në çdo lloj mënyre.

“Hua” është shuma e përgjithshme e principalit të Huamarrjeve të tërhequra sipas Shumës së Kredisë dhe ende të papaguara.

“Datat e Shlyerjes së Detyrueshme” nënkupton datat në çdo vit, të përcaktuara në shtojcën 3, me kusht që nëse një nga këto data nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

“OeKB” është Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, A-1011 Vienna, Austria, që vepron si Agjenci Kredie Eksporti për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

“Garanci e OeKB-së” është një garanci numër 232,653, e lëshuar nga OeKB-ja në lidhje me Shumën e Kredisë, për dhe në emër të Republikës së Austrisë në përputhje me ligjin për nxitjen e eksportit 1981, i ndryshuar.

“Procedurë Pagesë” është procedura për pagesën e Huamarrjeve të specifikuara në shtojcën 4.

“Projekti” është projekti i specifikuar në shtojcën 2.

“Blerësi i Projektit” është blerësi i projektit i përkufizuar në shtojcën 2.

“Eksportues Projekti” është eksportuesi austriak i përkufizuar në shtojcën 2.

“Datë e Pranimit të Përkohshëm” është data në të cilën Huadhënësi ka marrë nga Eksportuesi i Projektit kopjen e Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm;

“Certifikatë e Pranimit të Përkohshëm” është një certifikatë e pranimit provizor në formën e COHO-s (Certifikatë për Dorëzimin sipas përcaktimit dhe parashikimit në Marrëveshjen e Blerjes) të plotësuar dhe të nënshkruar rregullisht nga palët.

“Marrëveshje e Blerjes” është marrëveshja në lidhje me Projektin e lidhur ndërmjet Eksportuesit të Projektit dhe Blerësit të Projektit dhe e përkufizuar në shtojcën 2.

“Seksion” është një seksion i kësaj Marrëveshjeje.

2. SHUMA E KREDISË

2.1 Preambulë

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i termave dhe kushteve sipas të cilave Huadhënësi do të financojë 100 % të vlerës së përgjithshme të kontratës (por deri në një shumë maksimale të specifikuar si “Shuma e Kredisë” në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje) që duhet të paguhet nga Blerësi i Projektit për Eksportuesin e Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Shuma e Kredisë

Huadhënësi bie dakord t’i vërë në dispozicion Huamarrësit Shumën e Kredisë gjatë Periudhës së Disponueshmërisë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që një Huamarrje mund të bëhet nga Huamarrësi sipas Shumës së Kredisë në pajtim me Procedurën e Pagesës së përcaktuar në shtojcën 4 dhe zbatohet kundrejt pagesës së çmimit të kërkueshëm ndaj Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

Kredia e dhënë jepet sipas dhe në bazë të dispozitave të rregullave dhe të rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje thekson që financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,30 % (tridhjetë e pesë pike tridhjetë për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e një Huamarrjeje nëse kjo Huamarrje dhe interesi mbi të nuk do të mbulohej nga garancia e dhënë nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë në përputhje me ligjin për promovimin të eksportit 1981, i ndryshuar, dhe /ose marrëveshja e financimit me OeKB-në për Shumën e Kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e Huas

Huadhënësi hap një llogari të huas në euro në emrin e Huamarrësit, të përcaktuar si “Llogaria e Huas”. Çdo Huamarrje e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje debitohet në Llogarinë e Huas, në pajtim me këtë Marrëveshje, me vlerë në datën e pagesës së kësaj Huamarrjeje. Shlyerjet dhe parapagimet aplikohen përkatësisht në Llogarinë e Huas.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe Marrëveshjes së Blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë dështim i Eksportuesit të Projektit në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk ndikon mbi detyrimet e Huamarrësit kundrejt Huadhënësit, as nuk e bën Huadhënësin përgjegjës për dështimin e Eksportuesit të Projektit dhe/ose të ndonjë pale tjetër të Marrëveshjes së Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi për Llogarinë e Huas

Huamarrësi paguan interesin në Datat e Pagesës së Interesit me një normë fikse sipas specifikimit në shtojcën 3, të llogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Llogaritja dhe Data për Pagesën e Interesit

Interesi i kërkueshëm, në përputhje me seksionin 3.1 grumbullohet ditë pas dite, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një viti me 360 ditë dhe, përveç sa parashikohet në seksionin 6.1, do të paguhet në fund të çdo tremujori nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të pamundësisë së Huamarrësit, për të kryer në datën e duhur pagesën e çdo shume të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e kësaj mospagese deri në datën e pagesës aktuale në normën e caktuar në shtojcën 3. Kamatëvonesa, sipas këtij seksioni 3.3, do të jetë e kërkueshme në Datat e Pagesës së Interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit

Për periudhën që fillon në Datën e Mbylljes dhe që mbaron në fund të Periudhës së Disponueshmërisë, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e caktuar në shtojcën 3. Tarifa e angazhimit e kërkueshme në pajtim me këtë seksion 4.1 llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të Shumës së Kredisë në fillim të çdo tremujori kalendarik dhe paguhet në fund të çdo periudhe nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit. Pagesa e parë e tarifës së angazhimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në Datën e parë të Pagesës së Interesit pas Datës së Mbylljes.

4.2 Tarifa e menaxhimit

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditë Pune para disbursimit të parë të Shumës së Kredisë) do t'i paguajë Huadhënësit tarifën e menaxhimit të specifikuar në shtojcën 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi i paguan më tej Huadhënësit, me kërkesë, shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe të udhëtimit, dhe shpenzimet mbi garancinë e OeKB-së), të bëra nga Huadhënësi në lidhje me padinë për kompensim të çdo shume të kërkueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje.

ii) Të gjitha taksat, tatimet, shpenzimet ose detyrimet e tjera të vendosura për Huadhënësin nga Ministria e Financave, Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë për llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin.

4.4 Primi i Garancisë

Sipas Marrëveshjes, Huadhënësi i faturon Huamarrësit një kompensim për primin e garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Premiumi i Garancisë së OeKB-së dhe tarifa e administrimit të OeKB-së e pagueshme në fillim

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditë Pune para disbursimit të parë të Shumës së Kredisë) do t'i paguajë Huadhënësit një pjesë pjese fillestare të kompensimit për primin e garancisë të OeKB-së dhe tarifën e administrimit të përcaktuar në shtojcën 3 në shumat e përcaktuara në shtojcën 3.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së i pagueshëm si Marzh

Duke filluar nga Data e Pagesës së Interesit, që bie pas Datës së Mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë të OeKB-së, të pagueshëm si marzh, sipas specifikimit në shtojcën 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm çdo tre muaj në Datat e Pagesës së Interesit.

Grafiku i pagesës së shumave, që duhet të paguhet sipas seksionit 4.4, do të përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi do të informojë Huamarrësin përkatësisht për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit primi i Garancisë së OeKB-së rritet, për shkak se: i) vlerësimi i riskut tregtar të bërë nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e Garancisë së OeKB-së ka ndryshuar; ose ii) ndryshimet thelbësore në termat kontraktuale të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit janë miratuar, Huamarrësi rimburson Huadhënësin për këtë rritje sipas kërkesës.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të Periudhës së Disponueshmërisë do të shlyhet nga Huamarrësi në një numër të barabartë këstesh gjashtëmujore shlyerjeje në Datat e Shlyerjes së Detyrueshme, të përcaktuara në shtojcën 3. Huadhënësi, brenda 15 ditëve kalendarike pas Datës së Pranimit të Përkohshëm, do të njoftojë Huamarrësin për listën e Datave të Shlyerjes së Detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në secilën prej këtyre datave.

5.2. Parapagimi opsional

Huamarrësi mund të parapaguajë Huan plotësisht ose pjesërisht (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në shtojcën 3 ose shumëfishat integralë të saj) pas dhënies së një njoftimi me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë kalendarike para (ky njoftim është i pakthyeshëm) datës së propozuar të parapagimit për Huadhënësin në bazë të aprovimit të OeKB-së dhe pagesave të çdo kostoje ndërprerjeje të shkaktuar Huadhënësit. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet gjatë Periudhës së Disponueshmërisë, do të zvogëlojë vlerën e Shumës së Kredisë me një vlerë të barabartë me këtë parapagesë. Çdo referencë ndaj Shumës së Kredisë në këtë Marrëveshje më pas

konsiderohet të jetë referencë ndaj shumës së specifikuar në shtojcën 3 dhe të reduktuar.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para çdo Date të Pagesës së Interesit ose, sipas rastit, Datës së Shlyerjes së Detyrueshme, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin për këto shuma që janë të kërkueshme për t'u paguar nga Huamarrësi për Huadhënësin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e angazhimit, me kusht që mosbërja e njoftimit si më sipër nuk e liron Huamarrësin nga detyrimi i tij për të kryer pagesat e këtyre shumave të lartpërmendura kur bëhen të kërkueshme.

Njoftimi specifikon, gjithashtu, për çdo pagesë që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (përvetësimin e shumave të kërkueshme dhe të pagueshme, të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi bën pagesën në mënyrën e këshilluar dhe konfirmon zbatimin e fondeve me shkrim. Huamarrësi këshillon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (përvetësimi i fondeve) për çdo shumë që i paguhet Huadhënësit. Nëse nuk merret ndonjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6

Nëse një shumë e caktuar debitohet dhe/ose kreditohet në Llogarinë e Huas dhe/ose ndonjë llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshjeje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike para Datës së Pagesës së Interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me këtë Datë të Pagesës së Interesit do të mbartet dhe do të bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme Huadhënësit në Datën e ardhshme pasuese të Pagesës së Interesit, përkatësisht do të (në rastin e shumave të kredituara) rillogaritët në Datën e ardhshme pasuese të Pagesës së Interesit.

6.2 Mënyra e pagesës

Në çdo Datë të Pagesës së Interesit, Datë të Shlyerjes së Detyrueshme ose në çdo datë tjetër të kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumave dhe monedhës së kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi, sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, në vlerën dhe datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat e shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi për Huadhënësin do të bëhen në Vjenë në euro lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

6.3 Heqja dorë nga kompensimi ose kundërpadia

Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë kompensimi ose kundërpadie që mund të ketë në lidhje me çdo shumë të detyrueshme kundërt Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesë, për çfarëdolloj arsyeje, të ndonjë shume të kërkueshme për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të mbajë pagesa të shumave të detyrueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje mbi bazën e një padie, të drejtë padie, të drejtë të ligjshme ose kërkesë kundër Eksportuesit të Projektit ose furnizuesve të tjerë në lidhje me Projektin.

6.4 Pagesat e lira nga mbajtja e taksave dhe detyrime të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa kompensim ose kundërpadi dhe do të jenë të lira dhe pa zbritje për ose në llogari të çdo takse, tatimi, shume të zbritur ose të mbajtur ose tarifa të tjera të tashme ose të ardhshme të çdo lloji natyre të Republikës së Shqipërisë, nëse Huamarrësit nuk i kërkohet me ligj ta bëjë këtë zbritje. Nëse kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë do të rritet në masën e nevojshme për të garantuar që pas kësaj zbritjeje të taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera, Huadhënësi të marrë në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse kjo zbritje e taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera nuk do të ishte kërkuar. Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit fatura, vërtetime ose dëshmi të tjera që provojnë shumat (nëse ka) e paguara ose të pagueshme në lidhje me çdo shumë të lartpërmendur të zbritur ose të mbajtur.

6.5 Kostot e rritura

Nëse rezultati i:

i) një ndryshimi në, ose prezantimit të një ligji, rregulloreje ose kërkesë rregullatore ose një ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre; ose

ii) përmbytjes nga Huadhënësi të çdo udhëzimi, kërkesë ose detyrimi (pavarësisht nëse e ka fuqinë e ligjit apo jo) të ndonjë banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose autoriteti tjetër,

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato që lidhen me përshtatshmërinë e kapitalit, likuiditetin, asetet rezervë dhe depozitat e veçanta), është:

a) të rrisë koston ose të vendosë kosto shtesë për Huadhënësin për vënien ose ruajtjen në dispozicion të

angazhimit të tij ose ruajtjen ose financimin e huas; dhe/ose

b) të redukojë shumën e pagueshme ose kthimin real për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) të redukojë normën e kthimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) t'i kërkojë Huadhënësit të kryejë një pagesë ose të heqë dorë nga një kthim mbi, ose të llogaritur ndaj çdo shume të arkëtuar ose të arkëtueshme nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

atëherë Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit sipas kërkesës çdo kosto të tillë, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim.

Çdo vërtetim i Huadhënësit në lidhje me këtë kosto, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jetë provë përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllimet e kësaj dispozite, Huadhënësi, në mirëbesim, mund të alokojë ose shpërndajë kostot dhe/ose humbjet mes aseteve dhe detyrimeve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) mbi bazën që e konsideron të përshtatshme.

6.6 Përvetësimi i pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kur Huadhënësi ndryshon urdhrin e zbatimit) do të zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi):

a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 (Tarifa e Menaxhimit dhe Shpenzimet);

b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.3 (Primi i Garancisë së OeKB-së);

c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (Tarifa e Angazhimit);

d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (Kamatëvonesa);

e) shumat e prapambetura sipas seksionit 3.1 (Interesi);

f) shumat e prapambetura sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);

g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);

f) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);

i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (Parapagimi Opsional).

Huadhënësi do të informojë Huamarrësin në lidhje me çdo aplikim të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën dhënë Huamarrësit nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi njeh që në bazë të Garancisë OeKB-ja ka rezervuar kundrejt Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar ndarjen e pagesave të përcaktuara më sipër. Në një rast të tillë, Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe do të marrë përsipër të shlyejë Huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Kjo Shumë Kredie do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën (Data e Mbylljes) kur Huamarrësi njoftohet nga Huadhënësi se kushtet e mëposhtme janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

i) Huadhënësi do të këtë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes, të pranueshme në formë dhe përmbajtje për Huadhënësin së bashku me një vërtetim nga Eksportuesi i Projektit në një datë jo më vonë se katërmëdhjetë ditë kalendrike para Datës së Mbylljes, me efektin që Marrëveshja e Blerjes në formën e paraqitur Huadhënësit është në fuqi dhe efekt të plotë (shtojca 6);

b) një opinion të Ministrisë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë të pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që Huadhënësi mund të kërkojë (sipas shtojcës 5), së bashku me kopje të certifikuar të çdo miratimi ose autorizimi të përmendur në këtë opinion;

c) një kopje të një vendimi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që miraton këtë Marrëveshje në parim;

d) një plotfuqi të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet të nënshkruhen dhe/ose dërgohen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar rregullisht nga një person ose disa persona të autorizuar me plotfuqinë e përmendur në paragrafin “d” më sipër;

f) nënshkrimet ekzemplarë të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit;

g) një emërim të një agjenti procesi për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (shtojca 7);

h) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që mund të kërkojë Huadhënësi për t'i dhënë kësaj Marrëveshjeje dhe transaksioneve të parashikuara në të një marrëveshje ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

ii) Huadhënësi do të ketë marrë:

a) një garanci të lëshuar nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në përputhje me aktin për promovimin e eksportit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e së cilës mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për Huan;

c) një marrëveshje plotësuese me Eksportuesin e Projektit dhe miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet e Huadhënësit.

d) Çdo kusht shtesë (nëse ka) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda Periudhës së Mbylljes, të përcaktuar në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit, sipas seksionit 4.2, kjo Marrëveshje nuk do të jetë më detyruese për palët.

Secili prej këtyre dokumenteve dhe njoftimeve do të jetë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk është në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze i bashkëlidhet dokumentit të lartpërmendur.

8.RASTET E MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

8.1 Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një Rast të Mosplotësimit të Detyrimeve:

a) ka pamundësi pagese nga Huamarrësi, për më shumë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike, të ndonjë principalit, interesi ose shume tjetër të kërkueshme në lidhje me Huan; ose

b) Huamarrësi është i paaftë për të përmbushur ose për të respektuar siç duhet kushte ose angazhime në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshme nga pagesa e principalit, interesi ose shuma të tjera për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data më e hershme në të cilën Huamarrësi vihet në dijeni të pamundësisë së pagesës dhe data në të cilën njoftimi me shkrim për këtë pamundësi që kërkon nga Huamarrësi rregullimin e kësaj pamundësie, i është dhënë më parë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose angazhim, e bërë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje, do të rezultojë të ketë qenë e pasaktë në aspekte materiale në kohën kur është bërë; ose

d) Huamarrësi do të jetë në mosplotësim të pagesës ose përmbushjes së një detyrimi në lidhje me paratë e marra hua, të ndryshme nga huaja (duke përfshirë në çdo rast një detyrim sipas një garancie); ose

e) çdo autorizim, pëlqim, regjistrim ose aprovim (zyrtar apo tjetër) të kërkuara për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose Huaje, ose ekzekutimi i të cilave është tërhequr, ose për ndonjë arsye pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë; ose

f) Republika e Shqipërisë shpall një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e pagesës ndaj kreditorëve të saj; ose

g) çdo ngjarje që ka, në diskrecionin e arsyeshëm të Huadhënësit, ndikim negativ material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë, e lëshuar nga OeKB-ja ose ndonjë prej dispozitave të saj është anuluar, ka përfunduar ose ka pushuar së qeni në fuqi dhe efekt, ose ka pushuar së dhëni garancinë e synuar, ose bëhet e paligjshme, ose shpallet e pavlefshme për arsye, raste ose rrethana që mund t'i atribuohen sferës së Huamarrësit.

8.2 Masat për Rastet e Mosplotësimit të Detyrimeve

Nëse ka ndodhur një Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve dhe në çdo kohë më pas ndonjë ose të gjitha prej masave të mëposhtme që mund të merren nga Huadhënësi, do të jenë të vazhdueshme:

a) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë principalin dhe interesin e shtuar në lidhje me Huan dhe të gjitha shumatat e tjera të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, si menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pas së cilit do të bëhen menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pa deklarim, kërkesë, kundërshtim ose njoftim tjetër të çdo lloji;

b) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë të përfunduar Shumën e Kredisë, pas së cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe për të vazhduar Huan sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë menjëherë; dhe

c) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë, sipas diskrecionit të tij absolut.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi mund të ketë si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për të ruajtur shuma të vonuara). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit, që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi të dukshëm) do të jenë prova përfundimtare të sasisë së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumente të përshtatshme.

Huamarrësi, sapo të vihet në dijeni për këtë, do t'i japë njoftim me shkrim Huadhënësit, për:

- a) çdo Rast të Mosplotësimit të Detyrimeve; ose
- b) çdo kusht, ngjarje ose veprim që, me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, ose përmbushjen e ndonjë kushti mund të çonte ose përbënte një rast të mosplotësimit të detyrimeve.

9. GARANCITË DHE ANGAZHIMET

9.1 Garancitë

Me qëllim inkurajimin e Huadhënësit për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të përfituar dhe mbajtur Huan e parashikuar në këtë Marrëveshje, Huamarrësi jep garancitë e mëposhtme në Datën e Pranimit:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Huamarrësi nuk është në mosplotësim të ndonjë prej detyrimeve të tij të pagesës dhe nuk ka ndodhur ose nuk po vazhdon asnjë Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve; ose

c) Huamarrësi ka autoritetin për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua sipas saj dhe për të nënshkruar, dërguar dhe përmbushur këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të pranuar kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, që përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj; ose

d) nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të shkelë dispozitat e ndonjë ligji ose rregulloreje të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshjeje, kontrate ose angazhimi tjetër në të cilën Huamarrësi është palë ose që është detyruese për të ose asetet e tij; ose

e) të gjitha autorizimet, miratimet, regjistrimet ose aprovimet (zyrtare ose të tjera) të nevojshme në lidhje me nënshkrimin, dorëzimin, përmbushjen, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

Garancitë e paraqitura më sipër do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit.

9.2 Angazhimet

Huamarrësi merr përsipër dhe angazhohet me dhe për Huadhënësin, si më poshtë:

a) Të dhënat

Huamarrësi do të marrë masa:

1. që: i) Blerësi i Projektit të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga Huaja; ii) Blerësi i Projektit informon në lidhje me përdorimin e tyre në Projekt; dhe iii) Blerësi i Projektit regjistron progresin e Projektit, duke përfshirë koston e tij;

2. që përfaqësuesit e Huadhënësit të lejojnë të inspektojnë Projektin, angazhimin e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument tjetër;

3. për të informuar Huadhënësin, ose të bëjë që t'i dërgohet Huadhënësit i gjithë informacioni që Huadhënësi kërkon në lidhje me shpenzimet e Huas, Projektin dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes.

b) Njëvlershmëria dhe Pengu Negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe njëlloj me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara, të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga Data e Pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e Huas do të mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose do të bjerë dakord për të krijuar ndonjë hipotekë, detyrim, peng, barrë ose interes tjetër garancie mbi të gjithë ose një pjesë të aseteve të tij për të siguruar detyrime ose garanci të ndonjë detyrimi, nëse Huaja nuk sigurohet në mënyrë të barabartë dhe përpjesëtimore, të pranueshme për Huadhënësin.

c) Ndryshimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk do të bëjë, lejojë ose miratojë ndonjë amendim, ndryshim, modifikim ose përfundim të Marrëveshjes së Blerjes, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

- a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.
- b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin mbi këtë Marrëveshje, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra, sipas Rregullave të Pajtimimit dhe Arbitrazhit, në atë kohë në fuqi, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.
- c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që do të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja.
- d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për kostot e shkaktuara nga palët.
- e) Arbitrat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të kryer procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi për vendimin mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose masa të tjera zbatuese ose mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi. Pavarësisht sa më sipër, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje me: i) pronat e tij të misionit diplomatik ose konsullor të Republikës së Shqipërisë; ii) pronën e një karakteri ushtarak dhe nën kontrollin e një autoriteti ushtarak apo agjencie të mbrojtjes; iii) pronën që ndodhet në Republikën e Shqipërisë dhe është e dedikuar për përdorim publik ose qeveritar.

h) Huamarrësi do të caktojë Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si agjentin e tij të procesit në Vjenë (shtojca 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, shkresat, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të jenë të vlefshme në rast njoftimi me shkrim me letër rekomande kur merret, ose në rast të njoftimit me faks, kur merret nga pala për të cilën ky njoftim, kjo shkresë, kërkesë ose komunikim tjetër kërkohet ose lejohej të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit, përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në shtojcën 1, ose në një adresë tjetër që njëri prej tyre mund të caktojë më pas me shkrim për tjetrin në përputhje me seksionin 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përkufizojnë apo kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqja dorë, Mjetet Mbrojtëse Kumulative

Asnjë pamundësi ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë moment mirëkuptimi ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk do të operojë si heqje dorë nga to; një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore, të parashikuara shprehimisht në këtë marrëveshje, janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte në rast të kundërt. Asnjë njoftim ose kërkesë ndaj Huamarrësit nuk autorizon Huamarrësin në ndonjë rast për njoftim ose kërkesë tjetër ose të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana ose nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje çmohet nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent gjyqësor, si e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të saj nuk do të cenohet ose dëmtohet dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshme në pajtim me qëllimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje: i) pa pëlqimin e Huamarrësit, nëse përfituesi është OeKB-ja ose (në rast vetëm të Mosplotësimit të Detyrimeve) çdo bankë ose institucion tjetër financiar; dhe ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, që nuk do të ndalohet në mënyrë të paarsyeshme, te ndonjë përfitues tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të paraqitur në një mënyrë që është e zakonshme nga bankat, të gjithë informacionin që ai merr në lidhje me këtë Marrëveshje ose marrëdhënien e tij të punës me Huamarrësin, veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve, për bankat, institucionet e përbashkëta të bankave ose organizatat e përzgjedhura për mbrojtjen e kreditorëve.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie më tej dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të dhënë informacion që rezulton nga kjo Marrëveshje ose nga marrëdhënia e punës së Huadhënësit me Huamarrësin për personat ose shoqëritë e mëposhtme:

- a) çdo anëtar të grupit të shoqërive të Huadhënësit;
- b) një përfitues i mundshëm që i transferohen të drejtat ose një personi apo shoqërie që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;
- c) OeKB-në dhe Republikën e Austrisë; dhe
- d) çdo person, autoritet ose subjekt tjetër, për të cilin Huadhënësi i kërkohet të japë këtë informacion sipas ndonjë ligji ose urdhri gjykatë ose organi tjetër gjyqësor, ose organi rregullator, udhëzimet e të cilit duhet të përmbushen nga Huadhënësi.

11.7 Ndryshimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të modifikohet ose të ndryshohet përveç se me instrumente me shkrim.

12. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe miratimin nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botimin në gazetën zyrtare shqiptare të quajtur Fletore Zyrtare.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më parë më sipër në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe versionin në gjuhën angleze do të jetë detyrues dhe do të ketë përparësi mbi të gjitha përkthimet.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

që vepron në emër të REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

dhe përfaqësuar nga MINISTRIA E FINANCAVE

(Vulë:)

.....
UNICREDIT BANK AUSTRIA AG

.....

SHTOJCA 1

PALET

Huamarrësi:

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe që përfaqësohet nga Ministria e Financave)

Departamenti: Ministria e Financave

Adresa: Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1

Tiranë/Shqipëri

Tel. (355 4) 222 84 05

Fax: (355 4) 222 84 94

Në vëmendje të: Znj. Mimoza Loli

Huadhënësi

Emri: UNICREDIT BANK AUSTRIA AG

Adresa: Schottengasse 6-8

1010 Vienna, Austria

Department: 8243 Export Finance

Telephone: + 43 50505 - 56326

Fax: + 43 50505 - 56934

Në vëmendje të: Mr. Gerd Rose

SHTOJCA 2 PROJEKTI

Projekti:

Dhënia e pajisjeve dhe e shërbimeve për Projektin Mbarëkombëtar të Radioterapisë të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në Tiranë, me një vlerë të përgjithshme projekti prej 2.000.000 eurosh.

Eksportues i Projektit:

Philips Austria GmbH Triester StraÙe 64 A1100 Wien Austria

Blerësi i Projektit:

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë

Bulevardi “Bajram Curri”, nr. 1

Tiranë

Shqipëri

Marrëveshja e Blerjes:

Kontratë Blerjeje për Projektin Mbarëkombëtar të Radioterapisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri; nr. TA-ALB-12, datë 20 dhjetor 2012, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë si blerës dhe Philips Austria GmbH si shitës.

SHTOJCA 3

1. Shuma e Kredisë (seksioni 2.2)

Një shumë që nuk kalon 2.000.000 euro (dy milionë euro).

2. Periudha e Disponueshmërisë (seksioni 2.2)

Periudha që fillon nga dhe duke përfshirë Datën e Mbylljes (siç përcaktohet në seksionin 7), deri në duke përfshirë ditën që bie 9 muaj pas Datës së Mbylljes, ose një datë të mëvonshme sipas specifikimit të herëpashershëm të Huamarrësit.

3. Interesi (seksioni 3.1)

0 (zero) për qind në vit

4. Kamatëvonesa (seksioni 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% p.a.

5. Tarifa e angazhimit (seksioni 4.1)

0,5% p.a. (zero pikë pesë për qind në vit)

6. Tarifa e menaxhimit (seksioni 4.2)

0,5% (zero pikë pesë për qind) e pandryshueshme ndaj Shumës së Kredisë

7. Primi i Garancisë (seksioni 4.3)

i) Primi i Garancisë së OeKB-së që paguhet në fillim

EURO 20,000 (vetëm treguese).

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB-ja me lëshimin e Garancisë së OeKB-së. Në rast se shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e treguar, Huamarrësi do të paguajë diferencën (nëse ka) brenda 30 ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar për këtë nga Huadhënësi.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së i pagueshëm si Marzh

1.0% (një për qind) në vit (vetëm treguese).

Sipas OeKB-së norma e mësipërme mbështetet nga një grant shtesë që është afërsisht 146.666,67 euro nga Ministria Federale Austriake e Financave. Norma përfundimtare dhe granti, nëse ka, do të përcaktohen nga OeKB-ja me lëshimin e garancisë origjinale.

8. Tarifa e administrimit e OeKB-së 1.440 euro në lidhje me Sigurimin e Kredisë së Eksportit.

9. Datat e Detyrueshme të Shlyerjes (seksioni 5.1)

Shlyerja duhet të bëhet deri në 19 këste të barabarta gjashtëmujore të njëpasnjëshme, ku i pari është i kërkueshëm 60 muaj pas Datës së Përkohshme të Pranimit, në çdo rast jo më vonë se 31 maj 2018.

10. Shuma e Parapagimit Opsional (seksioni 5.2)

250.000 euro

11. Periudha e Mbylljes (seksioni 7)

Një periudhë që fillon në Datën e Pranimit dhe jo më vonë se deri 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas Datës së Pranimit.

SHTOJCA 4
PROCEDURA E PAGESËS

Huamarrësi autorizon Huadhënësin në mënyrë të përvokueshme që të paguajë Eksportuesin e Projektit deri në maksimumin e përgjithshëm të Shumës së Kredisë, të përmendur në shtojcën 3, kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme pranë Huadhënësit:

a) Në rastin e parapagimit (15% të çmimit të përgjithshëm të kontratës sipas Marrëveshjes së Blerjes që është 300.000 euro):

i) Fatura tregtare e Eksportuesit të Projektit (3 kopje origjinale dhe 7 kopje);

ii) Kopje të detyrimit të performancës të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 5% të çmimit të plotë të kontratës sipas Marrëveshjes së Blerjes;

iii) Kopje të garancisë së parapagimit të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 10% të çmimit të plotë të kontratës sipas Marrëveshjes së Blerjes.

b) Në rastin e pagesës kundrejt dorëzimit (80% të çmimit të përgjithshëm të kontratës sipas Kontratës së Blerjes që është 1.600.000 euro):

i) Fatura tregtare e Eksportuesit të Projektit 3 (tri) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;

ii) Certifikata e sigurimit në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;

iii) listë paketimi në 1 (një) kopje origjinale dhe 6 (katër) kopje;

iv)....

aa) International Truck-Waybill (CMR) në 3 (tri) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje; ose

bb) "On Board" ocean bill of lading ose FIATA combined transportation bill of lading në 3 (tri) kopje origjinale dhe 3 (tri) të sigluara që tregojnë Blerësin e Projektit si palë njoftuese; ose

cc) Airway Bill në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje,

ku secila prej tyre përcakton portin/aeroportin e destinacionit në Shqipëri, transportin e parapaguar dhe numrin e kontratës TA-ALB-12;

c) Në rastin e pagimit përfundimtar (5% të çmimit të përgjithshëm të kontratës sipas Marrëveshjes së Blerjes që është 100.000 euro):

i) Fatura tregtare e Eksportuesit të Projektit 3 (tri) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;

Certifikata e Pranimit të Përkohshëm në 3 (tri) kopje;

Huadhënësi ka të drejtë të mbështetet në çdo dokument që besohet prej tyre që është i vërtetë dhe i saktë dhe të jetë nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk merr përgjegjësi apo detyrim për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin ose efektin ligjor të një dokumenti(eve), ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuara në dokument(e) ose të vendosura në to; ai nuk merr përgjegjësi ose detyrim as për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, gjendjen, paketimin, dorëzimin, vlerën ose ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga një dokument(e), apo për mirëbesimin e veprimeve dhe/ose mosveprimeve, paaftësinë paguese, përmbushjen ose gjendjen nga dërguesit, transportuesit, paraqitësit, marrësit ose siguruesit e mallrave dhe asnjë person tjetër të tillë.

Dërgimet e pjesshme dhe paraqitja e pjesshme e dokumenteve lejohet.

Huadhënësi i jep Huamarrësit një njoftim me shkrim pasi të jetë kryer një Huamarrje ndaj Eksportuesit të Projektit.

Pas kryerjes së një Huamarrjeje për Eksportuesin e Projektit, Huadhënësi do të dërgojë dokumentet përkatëse Huamarrësit, në vëmendje të: Znj. Mimoza Loli, adresa: Ministria e Financave, Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, Shqipëri, me shërbim të veçantë korrieri.

SHTOJCA 5
MENDIMI LIGJOR
(Ekzemplar)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë:

Drejtuar: UniCredit Bank Austria AG

Datë

Unë,, duke vepruar në zotësinë time si ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232,653 për një shumë prej 2.000.000 eurosh

(Marrëveshja), datë 15 mars 2013 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës” dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës). Unë nuk shpreh asnjë mendim në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni përveçse të Republikës së Shqipërisë.

Unë kam shqyrtuar një kopje të nënshkruar të Marrëveshjes dhe ato dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të duhura për t’i shqyrtuar, me qëllim që të jap këtë mendim. Termat e përkufizuar në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur përkufizohen ndryshe.

Bazuar sa më sipër, unë jam i mendimit që:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Republikës së Shqipërisë. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republikës së Shqipërisë mund të ngrihet padi në emrin e saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Huamarrësit. Si pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, ligjërishit detyruese dhe të zbatueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka autoritet të ngrejë padi dhe të paditet në emrin e tij;

c) Huamarrësi gëzon autoritetin për të lidhur/nënshkruar dhe realizuar Marrëveshjen. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, si dhe ekzekutimin, shpalljen dhe realizimin e Marrëveshjes;

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. në cilësinë e tij si ministër i Financave i Republikës së Shqipërisë;

e) Marrëveshja e nënshkruar nga ministri i Financave në emër të Huamarrësit përbën detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin, të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me termat e saj;

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, të cilët nënshkruajnë apo vërtetojnë çdo dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen, kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të vepruar kështu në emër të Huamarrësit;

g) Nënshkrimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuara në lidhje me të nuk janë në kundërshtim me: i) ligjet, rregulloret ose urdhrat zyrtarë apo gjyqësorë; ii) traktatet, marrëveshjet ose dokumente apo instrumente të tjera në të cilët Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë janë palë ose që janë detyruese mbi të apo mbi asetet e saj përkatëse;

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (përfshirë, nëse është e nevojshme, aprovimet e shkëmbimeve të kontrollit), miratimet, lejet, përjashtimet, të dhënat, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike të nevojshme ose të rekomandueshme në lidhje me ekzekutimin, zbatimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes apo çdo pagesë të realizuar sipas saj, janë lëshuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi gëzon autoritetin e plotë për të kryer të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në euro (euro);

i) Të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të bëhen të lira dhe pa zbritje për ose për sa u përket çdo tarife, takse, zbritjeje apo detyrimi, nga Republika e Shqipërisë, çdo autoriteti tatimor apo nënndarjeje politike. Në rast të një ndalimi/zbritjeje për sa i përket pagesave të interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumën shtesë sipas paragrafit 6.4 mbetet i vlefshëm dhe i zbatueshëm;

j) Kjo Marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe është botuar në gazetën zyrtare shqiptare, që quhet Fletore Zyrtare dhe nuk është e nevojshme ose e këshillueshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria ose pranueshmëria si dëshmi të Marrëveshjes, në mënyrë që të arkivohet apo regjistrohet pranë një autoriteti tjetër qeveritar ose agjencie në Republikën e Shqipërisë;

k) Zgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë;

l) Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Hyrja në fuqi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën veprim juridik, privat dhe tregtar. Heqja dorë nga imuniteti në seksionin 10 (g) të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin;

m) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që t’i mundësohet Huadhënësit të zbatojë të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose ii) për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, të kualifikohet ose t’i jepet e drejta për të kryer veprimtari biznesi në Republikën e Shqipërisë;

n) Huadhënësi as është, as do të jetë rezident, banues, as nuk do të kryejë veprimtari biznesi apo t’u

nënshtrohet tatimeve në Republikën e Shqipërisë për shkak vetëm të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes;

m) Dispozitat e seksionit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë;

n) Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar, dhe do t'i zbatojnë këto vendime gjyqësore dhe/ose vendime arbitrazhi;

o) Një vendim i përcaktuar në euro (euro) do të njihet dhe do të zbatohet në Republikën e Shqipërisë;

p) Sipas njohurive të mia, nuk ekziston asnjë procedim gjyqësor, arbitrazhi apo administrativ aktual apo i mbetur pezull ose, që sipas informacionit tonë, do të kryhej ndaj Huamarrësit, që do të kishte rezultuar ose mund të rezultonte në një ndryshim të pafavorshëm material në gjendjen financiare apo korporative të Huamarrësit;

r) Marrëveshja dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që do të konsiderohet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë;

s) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes do të renditen në çdo kohë të barasvlershme me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç atyre detyrimeve të parashikuara si të detyrueshme me ligj.

Ky opinion ligjor jepet vetëm në interes të Huadhënësit dhe nuk mund t'u bëhet i ditur personave të tjerë.

Sinqerisht juaji

SHTOJCA 6

KONFIRMIM QË MARRËVESHJA E BLERJES ËSHTË NË FUQI DHE EFEKT TË PLOTË

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232,653 për një shumë prej 2.000.000 eurosh (Marrëveshja e Kredisë së Eksportit), datë 15 mars 2013 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënës).

Të dashur zotërinj,

Ne konfirmojmë që Kontrata e Blerjes për Projektin Mbarëkombëtar të Radioterapisë, Qendra Universitare Spitalore "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri; nr. TA-ALB-12, datë 20 dhjetor 2012, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë si blerës dhe Philips Austria GmbH si shitës ka hyrë në fuqi më (.....) duke iu nënshtruar vetëm efektivitetit të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit.

Vjenë,

.....

(Eksportues i Projektit)

SHTOJCA 7

PRANIMI I EMËRIMIT TË AGJENTIT TË PROCESIT

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232,653 për një shumë prej 2.000.000 eurosh (Marrëveshja e Kredisë së Eksportit), datë 15 mars 2013 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënës).

Të dashur zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, emërimin si agent i autorizuar i Huamarrësit për të shërbyer si agjent i procesit sipas dhe në lidhje me Marrëveshjen e Kredisë së Eksportit.

Adresa ime në Vjenë është:

Nëse do të ketë ndryshime në adresën time, unë do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Gjithë të mirat

.....

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri

vendi, data.....